

REPUBLIKA E SHQIPERISË  
ZYRA E NOTERISË TIRANË  
NR. 888 Rep.  
NR. 262 Kol.



A2022053840017968570



**KONTRATË SHITESË KONCESIONI  
PËR  
DISA NDRYSHIME NË KONTRATËN E KONCESIONIT TË FORMËS “BOT”  
(NDËRTIM-OPERIM-TRANSFERIM)  
PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALIT “SELCA 2 DHE MESMAL”, E  
NDRYSHUAR.**

Në Tiranë, më datë 28 muaji dhjetor, viti 2022 (dymijë e njëzet e dy), para meje noter Tiasno anëtar i dhomës së Noterisë Tiasno, me adresë Tiasno, u paraqitën palët kontraktuese si më poshtë:

**Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë**, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, përfaqësuar me autorizim të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë Nr.409/1 Prot., datë 09.02.2022 (kopje bashkëlidhur) nga Z. \_\_\_\_\_, i datëlindjes \_\_\_\_\_ madhor dhe me zotësi juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u sigurova nga Leternjoftim ID

**DHE**

Subjekti për qëllime të vecanta, shoqëria **“Energjia Valamara” Shpk**, themeluar si person juridik datë 13.10.2015 dhe rregjistruar në QKB datë 15.10.2015, me NUIS L54615003D. e përfaqësuar ligjërisht nga administratori i shoqërisë Z. \_\_\_\_\_, i datëlindjes \_\_\_\_\_, madhor dhe me zotësi juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u sigurova nga Pasaporta Nr. \_\_\_\_\_


**të cilët me vullnetin e tyre të lirë, bien dakord si më poshtë:**

Të lidhin këtë Kontratë Shtesë konçesioni, si pjesë përbërëse e Kontratës së Konçesionit të formës “BOT” për ndërtimin e hidrocentraleve “Selca 2 dhe Mesmal”, lidhur ndërmjet Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë dhe Subjektit për Qëllime të Veçanta, shoqërisë “Energjia Valamara” sh.p.k me Nr. 869 Rep. & Nr. 398/1 Kol, hyrë në fuqi me nënshkrimin nga palët në datën 28 Dhjetor 2015 e ndryshuar me kontratën shtesë të konçesionit Nr.768 Rep., Nr.258 Kol., datë 07.08.2017, e ndryshuar me kontratën shtesë të konçesionit Nr.2535 Rep., Nr.1714/1 Kol., datë 11.12.2018.

**Hyrje**

**Duke pasur parasysh që:**

- Ndërmjet Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë (Autoritet Kontraktues) dhe shoqërisë “Energjia Valamara” sh.p.k (Konçesioni) është lidhur Kontrata e Konçesionit të formës “BOT” për ndërtimin e hidrocentraleve “Selca 2 dhe Mesmal” me Nr. 869 Rep. & Nr. 398/1 Kol, datë 28 Dhjetor 2015 (në vijim referuar si “Kontrata e Konçesionit”);

-   
 03.05.2020
- Referuar Relacionit të Oponencës Teknike, dërguar nga AKBN Nr. 1562/4 prot., datë 01.03.2017 (prot. në MEI me Nr. 144/19, datë 03.05.2019) rroku për projektin e zbatimit të hidrocentraleve “Mesmal 1,2,3” & “Selca 2”, AKBN shprehet se skema e shfrytëzimit hidroenergetik të pellgut ujëmbledhës të përroit të Mesmalit dhe lumit të Selcës respekton kufijtë koncesionare të kontratës së koncesionit dhe rekomandon pasqyrimin në Kontratën Shtesë të Koncesionit të vlerave të rritura të parametrave hidroenergetikë sipas projektit të zbatimit;
  - Shkresës Nr. 144/23 prot., datë 15.05.2017 “Miratohet projekti i zbatimit i hidrocentraleve “Mesmal 1,2,3” & “Selca 2”, Autoriteti Kontraktues është shprehur për pasqyrimin në kontratë të ndryshimeve të parametrave hidroenergetikë, në përputhje me projektin e zbatimit;
  - Kontratës Shtesë të Koncesionit Nr.768 Rep., Nr.258 Kol., datë 07.08.2017 të lidhur ndërmjet Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë dhe Subjektit për Qëllime të Veçanta, shoqëria “Energjia Valamara” sh.p.k., “Për disa ndryshime në Kontratën e Koncesionit të formës “BOT”, për ndërtimin e hidrocentraleve “Selca 2 dhe Mesmal”.
  - Kontratës Shtesë të Koncesionit Nr.2535 Rep., Nr.1714/1 Kol., datë 11.12.2018 të lidhur ndërmjet Minsitrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Subjektit për Qëllime të Veçanta, shoqëria “Energjia Valamara” sh.p.k., “Për një ndryshim në Kontratën e Koncesionit të formës “BOT”, për ndërtimin e hidrocentraleve “Selca 2 dhe Mesmal”, e ndryshuar.
  - Shkresës së shoqërisë “Energji Valamara” sh.p.k., për përmirësimin e parametrave hidroteknikë të projektit për ndërtimin e Hec-eve “Mesmal 1, 2, 3 dhe Selcë”, ku në vijim MIE me shkresën Nr. 9533/1Prot. datë 18.12.2019 dërgon për vlerësim në AKBN projektin e ndryshuar të zbatimit të shoqërisë “Energjia Valamara” sh.p.k.
  - Shkresës së AKBN-së, Nr. 1036/3 Prot. datë 24.02.2020 “Dërgohet raporti i oponencës teknike mbi projektin e zbatimit të ndryshuar të Hec-eve Mesmal 1, 2, 3 dhe Selca 2”, të shoqërisë koncesionare “Energji Valamara” sh.p.k., protokolluar në MIE me Nr. 2178 Prot. datë 26.02.2020 me anë të së cilës, dërgon raportin e oponencës teknike dhe një kopje të vulosur të dokumentacionit të projektit të zbatimit të ndryshuar.
  - Shkresës së MIE-s Nr. 2178/2 Prot. datë 08.07.2020 “Mbi projektin e ndryshuar të zbatimit të hidrocentraleve Mesmal 1, 2, 3 dhe Selca 2”, në vijim të raportit të oponencës teknike, me anë të së cilës ka kërkuar edhe një herë qëndrimin e AKBN-së mbi saktësimin lidhur me kuotat e HEC-eve “Mesmal 1, 2, 3, dhe Selca 2”.
  - Shkresës së AKBN Nr. 894/4 Prot. datë 20.07.2020 “Mbi projektin e zbatimit të ndryshuar të Hec-eve Mesmal 1, 2, 3 dhe Selca 2”, protokolluar në MIE me Nr. 2178/3 datë 20.07.2020 ku sqaron se, nga pikëpamja teknike godina e centralit Hec Selca 2 do të ndërtohet në kuotën 662 m.m.n.d (kuota +0.00), kurse niveli i shkarkimit të ujit do të jetë 657 m.m.n.d, në krahun e djathtë të lumit Devoll, si dhe ulja e kufirit të mëposhtëm koncesionarë nuk cënon objekte të tjera në këtë pellg dhe këto ndryshime të bëra në projektin e zbatimit të Hec-eve “Mesmal 1, 2, 3 dhe Selca 2” janë të argumentuara drejtë dhe janë të mbështetura në studime mbështetëse.
  - Shkresës së MIE me Nr.5821/3 Prot., datë 30.12.2021 “Miratohet projekti i zbatimit i ndryshuar i HEC-eve “Mesmal 1,2,3 dhe Selca 2” me anë të së cilës Autoriteti Kontraktues miraton projektin e ndryshuar të zbatimit për ndërtimin e HEC-eve “Mesmal



1,2,3 dhe Selca 2", në pellgun ujëmbledhës të Devollit, në bashkëpunim me bashkëpunuesit lokalë dhe duke u shprehur e gatshme për të marrë pjesë në punën e ndërtimit dhe nënshkruar pasqyrohen ndryshimet e parametrit të kontratës së koncesionit të kësaj hidrocentrale. Këto ndryshime do të zbatohen menjëherë.

- Mbashtetur në nenin 28 "Ndryshime" të Kontratës së Koncesionit, ku parashikohet se kjo kontratë mund të ndryshohet me marrëveshje të nënshkruar midis dy palëve;
- Në nenin 29 "Bashkëpunimi midis Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit" të Kontratës së Koncesionit, ku parashikohet se Autoriteti Kontraktues dhe Koncesionari zotohen të bashkëpunojnë në mënyrë që të garantojnë realizimin e plotë të projektit;
- Në kontratën shtesë të koncesionit 2535 Rep., Nr.1714 Kol., datë 11.12.2018 në nenin 10 "Programi i punimeve" pika 10.2 përcaktohet se "...Koncesionari merr përsipër të verë në punë hidrocentralin/et brenda 28 (njëzet e tetë) muajve nga marrja e lejes së ndërtimit, siç është parashikuar në grafikun e punimeve (anexi 2 të kontratës së koncesionit).

Në Kontratën e Koncesionit të formës "BOT" për ndërtimin e hidrocentraleve "Selca 2 dhe Mesmal", nënshkruar nga palët datë 26.08.2016, me Nr. 869 Rep. & Nr. 303/1 Kol., në bashkëpunim me Kontratën Shtesë të Koncesionit Nr.768 Rep., Nr.258 Kol., datë 07.08.2017, amendyri me kontratën shtesë të koncesionit Nr.2535 Rep., Nr. 1714/1 Kol., datë 11.12.2018, të bëhen të vlefshme ndryshimet e mëposhtme;

Në nenin 1 "Përkufizime dhe interpretime",  
 Në pikën 1.5, shprehja: "...me fuqi të instaluar 6,000 (katërmijë e pesëqind e gjashtë) MW dhe prodhim të energjisë elektrike 16,700,000 (gjashtëmbëdhjetë milion shtatëqind e gjashtëmijë e shtatëqind e pesëdhjetë) kWh ...", do të ndryshohet me shprehjen: "...me fuqi totale të instaluar 6,000 (gjashtëmijë) kW dhe prodhim të energjisë elektrike 20,017,470 (njëzetëmilion e shtatëmbëdhjetë mijë e katërqind e shtatëdhjetë) kWh ...".

**Neni 3**

Neni 3, "Karakteristikat e hidrocentraleve", ndryshohet si më poshtë:

Hidrocentralet do të ndërtohen në pellgun ujëmbledhës të përroit të Mesmalit dhe lumit të Selcës, pellgu ujëmbledhës Devoll, bashkia Maq, me këto karakteristika:

HEC "Mesmal 1" Kuotat e veprave të marrjes	
Kuota e veprës së marrjes Nr.1(prr. Mesmal)	1650 m.m.n.d.
Kuota e veprës së marrjes Nr.2(prr. Thelië)	1650 m.m.n.d.
Kuota e godinës së centralit	1145.5 m.m.n.d.
Fuqia e instaluar	N= 1177 kW
Prodhimi vjetor i energjisë elektrike	E=4,157,743 kWh/vit

**HEC "Mesmal 2"**

Kuotat e veprave të marrjes	
Kuota e veprës së marrjes Nr.1(prr. Mesmalit, degë)	1474 m.m.n.d.
Kuota e veprës së marrjes Nr.2(prr. Mesmalit, degë)	1474 m.m.n.d.
Kuota e veprës së marrjes Nr.3(prr. Mesmalit, degë)	1472.8 m.m.n.d.
Kuota e godinës së centralit	1145.5 m.m.n.d.





A2022051040017968570

### Neni 6

Në nenin 23 "Sanksionet", në pikën 23.2. germa i. shprehja "... të prodhimit të energjisë elektrike prej 16,706,750 kWh/vit", zëvendësohet me shprehjen "... të prodhimit të energjisë elektrike prej 20,017,470 kWh/vit", si dhe shprehja në kllapa " (për sasi prej 400,962 kWh/vit)" zëvendësohet me shprehjen " (për sasi prej 480,419 kWh/vit)".

### Neni 7

Kjo Kontratë Shtesë Konçesioni hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët.

Kontrata Shtesë e Koncesionit u hartua në 5 (pesë) kopje dhe pasi iu lexua palëve, të cilët e kuptuan dhe e pranuan atë, e nënshkruan me vulnet të lirë e të plotë dhe unë noteri e vërtetoj atë rregullisht sipas ligjit.

PALET

**AUTORITETI KONTRAKTUES**

**Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë  
Përfaqësuar me Autorizim  
Nr. 409/1 Prot. datë 09.02.2022  
të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nga**

**Z.**

**ZËVENDËSMINISËR**

**SHOQËRIA KONCESIONARE  
"Energjia Valamara" sh.p.k**

**Përfaqësuar nga**

**Z**

**ADMINISTRATOR**